



**UNIVERSITETI I PRISHTINËS**  
**“HASAN PRISHTINA”**  
**FAKULTETI I SHKENCAVE MATEMATIKE NATYRORE**  
Rr. Eqrem Çabej, 10000 Prishtinë, Republika e Kosovës  
Tel: +381-38-249-873 • E-mail: [fshmn@uni-pr.edu](mailto:fshmn@uni-pr.edu) • [www.uni-pr.edu](http://www.uni-pr.edu)

FSHMN

Ref. nr.

2318

Prishtinë, Dt.

08.07.2024

**RAPORT VLERËSIMI TË DORËSHKRIMIT TË PUNIMIT TE DIPLOMES**  
**MASTER**

FAKULTETI	FSHMN
Departamenti/ Programi	KIMI/Kimi analitike dhe mjedisit
Projektpropozimi	NDIKIMI AMBIENTAL I FAKTORËVE ANTROPOGJEN NË BURIMET UJORE NË ZONËN E FERIZAJT
Kandidati	Arlinda Ramdani
Mentori	Prof. Ass. Jeton Halili
Aprovimi i projekt propozimit në Këshillin e Fakultetit	Datë: 29.09.2023 Vendimi nr.: 5190

**PËRMBLEDHJE E PUNIMIT**

Punimi i diplomës master i kandidatës Arlinda Ramdani trajton një çështje me rëndësi të madhe për mjedisin dhe shëndetin publik. Ky studim hulumton ndikimin mjedisor të aktiviteteve njerëzore në burimet ujore në zonën e Ferizajt, duke u fokusuar në burimet e ndotjes, cilësinë e ujit dhe shëndetin. Vlerëson shkallën e ndotjes, identifikon ndotësit kryesorë dhe ofron rekomandime për zbutjen e efekteve negative.

Kandidatja Arlinda Ramdani, fillon punimin e saj duke përshkruar rëndësinë e burimeve ujore, rolin e tyre esencial në ekosisteme, shëndetin e njeriut dhe aktivitetet ekonomike. Ajo nënvizon sfidat e paraqitura nga faktorët antropogjenë si shkarkimet industriale, rrjedhjet bujqësore dhe urbanizimi, që çojnë në degradimin e cilësisë së ujit.

**MATERIALET DHE METODAT**

Pjesa e metodologjisë përshkruan hapat e ndjekur për mbledhjen dhe analizimin e të dhënave. Janë përdorur metoda të ndryshme laboratorike për të analizuar mostrat e ujit nga burime të ndryshme në

zonën e Ferizajt. U përdorën metoda të standardizuara për të matur parametrat fizikë dhe kimikë të ujit, përqendrimin e metaleve të rënda dhe parametrat mikrobiologjikë.

### **Rezultatet dhe Diskutimi**

Diskutimi i punimit të diplomës master të kandidatës Arlinda Ramadani është një pjesë thelbësore e këtij studimi, duke ofruar një analizë të thellë të të dhënave eksperimentale dhe interpretimin e rezultateve të fituara. Bazuar në analizat bakteriologjike dhe fiziko-kimike të ujit në disa lokalitete të Komunës së Ferizajt, janë evidentuar rezultate të ndryshme, të cilat janë thelbësore për të vlerësuar sigurinë dhe cilësinë e ujit për komunitetin. Në aspektin bakteriologjik, uji në pjesën më të madhe të lokaliteteve ka treguar mungesë të baktereve koliforme dhe streptokokeve me prejardhje fekale, por është vënë re një numër i lartë i baktereve mezofile, të cilat kanë tejkaluar kufijtë e lejuar. Kjo situatë tregon për një aktivitet mikrobiologjik të rritur, që kërkon monitorim të rregullt.

Bazuar në rezultatet e parametrave fiziko-kimike, përgjithësisht uji i testuar nga këto lokalitete ka treguar përmbushje të standardeve referente, me parametra si era, ngjyra, turbiditeti, vlera e pH-së, dhe përqendrimet e klorureve, klorit rezidual, dhe nitrateve që janë brenda vlerave të pranueshme. Megjithatë, disa parametra si sulfatet dhe mbetjet pas avullimit në disa raste kanë tejkaluar vlerat referente, duke treguar nevojën për hulumtime të mëtejshme.

Në aspektin e metaleve të rënda, është vënë re se nivelet e arsenikut, kadmiumit, kobaltit, kromit, bakrit, merkurit, manganit, nikelit, dhe plumbit janë brenda kufijve të lejuar, që tregon mungesë të ndotjes së konsiderueshme nga këto metale. Hekuri dhe zinku kanë treguar ndryshime të vogla midis lokaliteteve, por janë gjithashtu brenda vlerave të pranueshme.

### **REKOMANDIMET**

Bazuar në rezultatet e studimit, disa rekomandime janë propozuar për të përmirësuar gjendjen e burimeve ujore në zonën e Ferizajt:

- Krijimi i një sistemi të rregullt të monitorimit të cilësisë së ujit për të identifikuar dhe adresuar problemet në kohë
- Forcimi i rregulloreve dhe politikave mjedisore për të kontrolluar dhe reduktuar ndotjen nga burimet industriale dhe bujqësore.
- Rritja e ndërgjegjësimit të popullsisë lokale mbi rëndësinë e mbrojtjes së burimeve ujore dhe ndikimin e ndotjes në shëndetin dhe mjedisin.
- Investimi në teknologji të avancuara për trajtimin e ujërave të zeza dhe pastrimin e ujit, për të siguruar ujë të pastër dhe të sigurt për komunitetin.

### Vlerësimi i Komisionit

Bazuar në analizën e dorëshkrimit të punimit të diplomës master të kandidatës Arlinda Ramadani, komisioni profesional sjell këto vlerësime:

Kandidatja ka dorëzuar punimin e saj në formë të plotë dhe sipas kërkesave të Statutit të Universitetit të Prishtinës dhe Rregullores për studime master.

Rezultatet eksperimentale janë trajtuar në mënyrë shkencore dhe me përpikëri, duke përmbushur standardet akademike të kërkuara. Ky aspekt demonstroi aftësinë e kandidatës për të kryer kërkime të mirëfillta shkencore dhe për të interpretuar të dhënat në mënyrë të saktë dhe të kuptueshme.

Kandidatja ka demonstruar një përvojë të shkëlqyeshme në aplikimin e metodave për trajtimin e ujërave të ndotura. Kjo tregon jo vetëm njohuritë teorike, por edhe aftësinë për të zbatuar këto njohuri në praktikë, duke sjellë zgjidhje konkrete për problemet mjedisore.

Komisioni profesional vlerëson pozitivisht këtë dorëshkrim të punimit të masterit dhe propozon që kandidatës Arlinda Ramadani ky punim t'i aprovohet si bazë për arritjen e gradës shkencore Master i Shkencave Kimike – drejtimi, Kimi analitike dhe mjedisit.

Prishtinë, 08/07/2024

Komisioni:

1. \_\_\_\_\_

/ Prof. Jeton Halili – mentor/

2. \_\_\_\_\_

/ Prof. Avni Berisha – anëtar/

3. \_\_\_\_\_

/ Prof. Skender Demaku – anëtar/

P.S. Numri i faqeve shtohet sipas nevojës.